



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit
Kancelarija Premijera - Office of the Prime Minister

**Raport mbi zbatimin e Programit Kombëtar për Integrim Evropian
(PKIE) gjatë periudhës korrik - shtator 2023**

Nëntor 2023
Prishtinë

Përmbajtja

HYRJE	4
0. PASQYRË E PËRGJITHSHME E ZBATIMIT TË PKIE-SË GJATË PERIUDHËS KORRIK – SHTATOR 2023 6	
0.1. Gjendja sipas blloqeve: Kriteret politike	11
0.2. Gjendja sipas blloqeve: Kriteret ekonomike	12
0.3. Gjendja sipas blloqeve: Standardet evropiane – përafrimi i legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së	13
0.4. Gjendja sipas institucioneve	14
1. BLOKU 1: KRITERET POLITIKE	17
1.1. Demokracia dhe sundimi i ligjit	17
1.1.1. Kushtetuta, parlamenti dhe sistemi zgjedhor	17
1.1.2. Administrata publike	17
1.1.3. Avokati i Popullit	18
1.1.4. Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë	18
1.2. Bashkëpunimi rajonal dhe obligimet ndërkombëtare	18
2. BLOKU 2: KRITERET EKONOMIKE 19	
2.1. Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut	19
2.2. Kapaciteti për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Unionit	19
3. BLOKU 3: STANDARDET EVROPIANE – PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME ACQUIS-NË E BE-SË	20
3.0. Korniza ligjore për përafrimin e legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së	20
3.1. Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave	20
3.2. Kapitulli 2: Liria e lëvizjes së punonjësve	21
3.3. Kapitulli 3: E drejta e themelimit të kompanive dhe liria e ofrimit të shërbimeve	21
3.4. Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit	21
3.5. Kapitulli 5: Prokurimi publik	22
3.6. Kapitulli 6: E drejta e kompanive	22
3.7. Kapitulli 7: E drejta e pronësisë intelektuale	23
3.8. Kapitulli 8: Politikat e konkurrencës	23
3.9. Kapitulli 9: Shërbimet financiare	24
3.10. Kapitulli 10: Shoqëria e informacionit dhe mediat	24
3.11. Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural	25
3.12. Kapitulli 12: Politikat e sigurisë së ushqimit, të veterinarisë dhe ato të fitosanitarisë	25
3.13. Kapitulli 13: Peshkataria	26
3.14. Kapitulli 14: Politikat e transportit	26
3.15. Kapitulli 15: Energjia	27
3.16. Kapitulli 16: Tatimet	28
3.17. Kapitulli 17: Politikat ekonomike dhe monetare	28
3.18. Kapitulli 18: Statistikat	28
3.19. Kapitulli 19: Politikat sociale dhe punësimi	29
3.20. Kapitulli 20: Politikat e ndërmarrjeve dhe ato të industrisë	29
3.21. Kapitulli 21: Rrjetet trans-evropiane	30
3.22. Kapitulli 22: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore	30
3.23. Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore	30
3.24. Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria	31
3.25. Kapitulli 25: Shkenca dhe kërkimet shkencore	32
3.26. Kapitulli 26: Arsimit dhe kultura	32
3.27. Kapitulli 27: Mjedisi	33

3.28. Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit	34
3.29. Kapitulli 29: Unioni Doganor	34
3.30. Kapitulli 30: Marrëdhëniet me jashtë	35
3.31. Kapitulli 31: Politika e jashtme, e sigurisë dhe ajo e mbrojtjes	35
3.32. Kapitulli 32: Kontrolli financiar	35
3.33. Kapitulli 33: Dispozitat financiare dhe ato buxhetore	35
<i>Shtojcë: Pasqyrë e zbatimit të PKIE gjatë vitit 2023 – gjendja e zbatimit deri në fund të tremujorit të tretë</i>	<i>36</i>

HYRJE

Programi Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) 2023 – 2027 është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 31 mars 2023 dhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 15 qershor 2023. Ai është dokument ligjërish i detyrueshëm për të gjitha organet e administratës shtetërore, të cilat obligohen të zbatojnë masat afatshkurtra nën përgjegjësinë e tyre. Qeveria, si mekanizmi qendror nacional përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve të MSA-së dhe kriterëve të tjera për integrim në Bashkimin Evropian (BE), mbikëqyr zbatimin e PKIE-së përmes institucionit kryesor për koordinimin e këtij procesi – Zyrës së Kryeministrit (ZKM). ZKM, përmes departamenteve përgjegjëse për integrim evropian, monitoron zbatimin e PKIE-së në baza tremujore, përmes raporteve të rregullta. Këto raporte shërbejnë për të vlerësuar dhe përmirësuar zbatimin e tij dhe për llogaridhënie e transparencë brenda institucioneve dhe ndaj palëve të tjera të interesuara e publikut të gjerë. Gjetjet, ndër të tjera, diskutohen nga kabineti i Qeverisë dhe nga organet e stabilizim-asociimit BE – Kosovë përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të MSA-së.

Ky është raporti i dytë për vitin 2023 dhe mbulon periudhën 1 korrik – 30 shtator. Të dhënat janë raportuar nga institucionet përgjegjëse përmes *Platformës online për monitorim dhe raportim për integrim evropian*, sipas udhëzuesit përkatës. Në kapitujt ku të dhënat janë raportuar me vonesë ose në mënyrë joadekuate, ato nuk janë përfshirë në raport dhe masat përkatëse janë vlerësuar si të pazbatuara plotësisht, ose që përballen me vonesa serioze. Zbatimi i programit është vlerësuar sipas statusit të ecurisë (paraqitur në diagrame) për të gjitha masat dhe për masat e planifikuara për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese (korrik – shtator). Zbatimi i të gjitha masave është vlerësuar sipas pesë niveleve të statusit të ecurisë:

- Masat e zbatuara (ato që janë zbatuar plotësisht) – me **të kaltër**;
- Masat në zbatim e sipër, pa vonesa (ato që kanë filluar së zbatuari dhe pritet të zbatohen në tërësi brenda afateve të parapara) – me **të gjelbër**;
- Masat që përballen me **vonesa të vogla** (ato që kanë filluar së zbatuari, por përballen me vonesa e probleme të vogla) – me **të verdhë**;
- Masat që përballen me **vonesa serioze** (ato që janë paraparë të zbatohen gjatë periudhës raportuese, por që akoma nuk janë zbatuar plotësisht në fund të kësaj periudhe, dhe përballen me vonesa e probleme serioze) – me **të kuqe**; dhe
- Masat e planifikuara për t'u zbatuar **në të ardhmen** (ato që akoma nuk kanë filluar së zbatuari dhe janë planifikuar të zbatohen në pjesën e mbetur të vitit) – me **të hirtë**.

Zbatimi i masave të planifikuara për t'u zbatuar gjatë periudhës raportuese është vlerësuar sipas dy niveleve të statusit të ecurisë:

- Masat e zbatuara – me **të kaltër**; dhe
- Masat e që përballen me vonesa serioze – me **të kuqe**.

Ky raport përmban katër kapituj dhe ndahet në dy pjesë: pjesa mbi Programin në tërësi dhe ajo mbi secilin bllok. Kapitulli 0 jep një pasqyrë të përgjithshme mbi gjendjen deri në fund të shtatorit në zbatimin e Programit në tërësi, në raport me tërë vitin dhe brenda periudhës raportuese. Ky kapitull është i ndarë në pesë pjesë: pjesa mbi Programin në tërësi, pjesa mbi kriteret politike, pjesa mbi kriteret ekonomike, pjesa mbi standardet evropiane, dhe pjesa sipas institucioneve. Secila pjesë përmban diagramin dhe pjesën narrative (shpjegimin e gjetjeve). Pjesa narrative mbi secilin bllok përmbillet me listën e masave që nuk janë zbatuar gjatë periudhës raportuese dhe ato që pritet të përballen me sfida gjatë periudhës në vijim.

Kapitujt 1, 2 dhe 3 janë uniformë – secili përmban nga dy pjesë për secilin kapitull të Programit: diagramin dhe pjesën narrative. Diagramet paraqesin gjetjet mbi nivelin e zbatimit të kapitullit përkatës: njëri *deri në fund të periudhës raportuese* (në raport me të gjitha masat e kapitullit) dhe tjetri *gjatë periudhës raportuese* (për masat e planifikuara për t'u zbatuar brenda tremujorit të tretë, pra korrik – shtator). Pjesa narrative jep një përmbledhje sasiore të këtyre gjetjeve. Në pjesën mbi zbatimin deri në fund të periudhës raportuese jepet numri dhe përqindja e masave sipas statusit të ecurisë nga të gjitha masat e planifikuara. Në pjesën mbi zbatimin gjatë tremujorit të tretë jepet numri dhe përqindja e masave të zbatuara nga masat e planifikuara për t'u zbatuar brenda këtij tremujori dhe atyre që përballen me vonesa serioze. Në këtë pjesë gjithashtu përshkruhet gjendja e përgjithshme në kapitullin përkatës.


Raporti gjithashtu përmban shtojcën, e cila paraqet gjendjen e zbatimit të të gjitha masave deri në fund të periudhës raportuese.

Gjetjet tregojnë se *gjatë tremujorit të tretë* të këtij viti *Programi* është zbatuar në nivel prej **41.38%: 12 nga 29 masat** e planifikuara për t'u zbatuar gjatë këtij tremujori janë zbatuar, ndërsa **58.62%** e tyre, 17 masa, akoma nuk janë zbatuar plotësisht (shihni diagramin 0.2, fq. 6). Për më tepër, *deri në fund të tremujorit të tretë i tërë Programi* është zbatuar në nivel prej **28.1%: 68 nga 242 masa** të planifikuara janë zbatuar, ndërsa **71.9%** e tyre (174 masa) akoma nuk janë zbatuar plotësisht (shihni diagramin 0.1, fq. 6). Nga 68 masat e zbatuara, 12 prej tyre janë zbatuar para afateve kohore (shihni shtojcën).

0. PASQYRË E PËRGJITHSHME E ZBATIMIT TË PKIE-SË GJATË PERIUdhËS KORRIK – SHtATOR 2023

Programi përmban 242 masa: 88 (36.36%) masa legislative dhe 154 (63.64%) masa zbatuese.

Diagrami 0.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: të gjitha masat




Sa i përket zbatimit të Programit deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 28.1% e masave, 68 masa, janë zbatuar;
- 39.26% e masave, 95 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 7.02% e masave, 17 masa, përballen me vonesa të vogla;
- 22.31% e masave, 54 masa, përballen me vonesa serioze;
- 3.31% e masave, 8 masa, janë planifikuar të zbatohen gjatë tremujorit të fundit të vitit.

Nga të gjitha masat e programit (242), 29 (11.98%) prej tyre ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë: 15 masa legislative dhe 14 masa zbatuese.

Diagrami 0.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: masat e planifikuara për këtë tremujor




Sa i përket zbatimit të masave të Programit të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 41.38% e masave, 12 masa, janë zbatuar;
- 58.62% e masave, 17 masa, akoma nuk janë zbatuar plotësisht, pra përballen me vonesa serioze.

Nga të gjitha masat e programit (242), 88 (36.36%) prej tyre janë masa legislative.

Diagrami 0.3. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: të gjitha masat legislative




Sa i përket zbatimit të masave legislative të Programit deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 31.82% e masave, 28 masa, janë zbatuar;
- 26.14% e masave, 23 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 7.95% e masave, 7 masa, përballen me vonesa të vogla;
- 32.95% e masave, 29 masa, përballen me vonesa serioze;

- 1.14% e masave, 1 masë, janë planifikuar të zbatohen gjatë tremujorit të fundit të vitit.

Nga të gjitha masat legislative të programit (88), 15 (17.04%) prej tyre ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 0.4. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: masat legislative të planifikuara për këtë tremujor




Sa i përket zbatimit të masave legislative të Programit të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 40% e masave, 6 masa, janë zbatuar;
- 60% e masave, 9 masa, akoma nuk janë zbatuar plotësisht, pra përballen me vonesa serioze.

Nga të gjitha masat legislative të programit (88), 30 (34.09%) prej tyre janë akte të legjislacionit kornizë, ose projektligje (përfshirë marrëveshjet ndërkombëtare).

Diagrami 0.5. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: të gjitha masat e legjislacionit kornizë




Sa i përket zbatimit të masave të legjislacionit kornizë deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 23.33% e masave, 7 masa, janë zbatuar;
- 26.67% e masave, 8 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 13.33% e masave, 4 masa, përballen me vonesa të vogla;
- 36.67% e masave, 11 masa, përballen me vonesa serioze.

Nga të gjitha masat të legjislacionit kornizë (29), 4 (13.79%) prej tyre ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 0.6. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: masat e legjislacionit kornizë të planifikuara për këtë tremujor




Sa i përket zbatimit të masave të legjislacionit kornizë të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 25% e masave, 1 masë, janë zbatuar;

- 75% e masave, 3 masa, akoma nuk janë zbatuar plotësisht, pra përballen me vonesa serioze.

Nga të gjitha masat legislative të programit (88), 58 (65.91%) prej tyre janë akte nënligjore dhe akte të tjera rregullative.

Diagrami 0.7. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative – të gjitha masat




Sa i përket zbatimit të masave legislative që janë akte nënligjore dhe akte të tjera rregullative deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 36.21% e masave, 21 masa, janë zbatuar;
- 25.86% e masave, 15 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 5.17% e masave, 3 masa, përballen me vonesa të vogla;
- 31.04% e masave, 18 masa, përballen me vonesa serioze;
- 1.72% e masave, 1 masë, janë planifikuar të zbatohen gjatë tremujorit të fundit të vitit.

Nga të gjitha masat legislative që janë akte nënligjore dhe akte të tjera rregullative (59), 11 (18.64%) prej tyre ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 0.8. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative – masat e planifikuara për këtë tremujor




Sa i përket zbatimit të masave legislative që janë akte nënligjore dhe akte të tjera rregullative të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 45.45% e masave, 5 masa, janë zbatuar;
- 54.55% e masave, 6 masa, akoma nuk janë zbatuar plotësisht, pra përballen me vonesa serioze.

Nga të gjitha masat e programit (242), 154 (63.64%) prej tyre janë masa zbatuese.

Diagrami 0.9. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: të gjitha masat zbatuese




Sa i përket zbatimit të masave zbatuese deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 25.97%. e masave, 40 masa, janë zbatuar;
- 46.75% e masave, 72 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;

- 6.49% e masave, 10 masa, përballen me vonesa të vogla;
- 16.23% e masave, 25 masa, përballen me vonesa serioze;
- 4.55% e masave, 7 masa, janë planifikuar të zbatohen gjatë tremujorit të fundit të vitit.

Nga të gjitha masat zbatuese të programit (154), 14 (9.09%) prej tyre ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 0.10. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: masat zbatuese të planifikuara për tremujorin e tretë




Sa i përket zbatimit të masave zbatuese të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 42.86% e masave, 6 masa, janë zbatuar;
- 57.14% e masave, 8 masa, akoma nuk janë zbatuar plotësisht, pra përballen me vonesa serioze.

Nga të gjitha masat zbatuese të programit (154), 54 (35.06%) prej tyre janë pjesë e kornizës së politikave.

Diagrami 0.11. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: korniza e politikave – të gjitha masat




Sa i përket zbatimit të masave zbatuese që janë pjesë e kornizës së politikave deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 31.48% e masave, 17 masa, janë zbatuar;
- 38.89% e masave, 21 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 3.7% e masave, 2 masa, përballen me vonesa të vogla;
- 25.93% e masave, 14 masa, përballen me vonesa serioze.

Nga të gjitha masat zbatuese të programit që janë masa të kornizës së politikave (54), 7 (12.96%) prej tyre ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 0.12. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: korniza e politikave – masat e planifikuara për këtë tremujor




Sa i përket zbatimit të masave zbatuese që janë pjesë e kornizës së politikave të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 42.86% e masave, 3 masa, janë zbatuar;

- 57.14% e masave, 4 masa, akoma nuk janë zbatuar plotësisht, pra përballen me vonesa serioze.

Nga të gjitha masat zbatuese të programit (154), 40 (25.97%) prej tyre janë reforma institucionale dhe për ngritjen e kapaciteteve institucionale.

Diagrami 0.13. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: reformat institucionale dhe për ngritjen e kapaciteteve institucionale – të gjitha masat




Sa i përket zbatimit të masave zbatuese që janë masa të reformave institucionale dhe për ngritjen e kapaciteteve deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 32.5% e masave, 13 masa, janë zbatuar;
- 37.5% e masave, 15 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 12.5% e masave, 5 masa, përballen me vonesa të vogla;
- 17.5% e masave, 7 masa, përballen me vonesa serioze.

Nga të gjitha masat zbatuese të programit që janë reforma institucionale dhe për ngritjen e kapaciteteve institucionale (40), 4 (10%) prej tyre ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 0.14. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: reformat institucionale dhe për ngritjen e kapaciteteve institucionale – masat e planifikuara për këtë tremujor




Sa i përket zbatimit të masave zbatuese që janë reforma institucionale dhe për ngritjen e kapaciteteve institucionale të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 25% e masave, 1 masë, janë zbatuar;
- 75% e masave, 3 masa, akoma nuk janë zbatuar plotësisht, pra përballen me vonesa serioze.

Nga të gjitha masat zbatuese të programit (154), 60 (38.96%) prej tyre janë masa të zbatimit në praktikë.

Diagrami 0.15. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: zbatimi në praktikë – të gjitha masat




Sa i përket zbatimit masave zbatuese që janë masa të zbatimit në praktikë deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 16.67% e masave, 10 masa, janë zbatuar;
- 60% e masave, 36 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;

- 5% e masave, 3 masa, përballen me vonesa të vogla;
- 6.66% e masave, 4 masa, përballen me vonesa serioze;
- 11.67% e masave, 7 masa, janë planifikuar të zbatohen gjatë tremujorit të fundit të vitit.

Nga të gjitha masat zbatuese të programit që janë masa të zbatimit në praktikë (60), 3 (5%) prej tyre ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 0.16. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: masat e zbatimit në praktikë të planifikuara për këtë tremujor




Sa i përket zbatimit të masave zbatuese të programit që janë masa të zbatimit në praktikë të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 66.67% e masave, 2 masa, janë zbatuar;
- 33.33% e masave, 1 masë, akoma nuk janë zbatuar plotësisht, pra përballen me vonesa serioze.

0.1. Gjendja sipas blloqeve: Kriteret politike

Ky bllok përmban 19 masa: 7 (36.84%) masa legislative dhe 12 (63.16%) masa zbatuese.

Diagrami 0.1.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Kriteret politike – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij blloku deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 15.79% e masave, 3 masa, janë zbatuar;
- 31.58% e masave, 6 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 42.11% e masave, 8 masa, përballen me vonesa serioze;
- 10.53% e masave, 2 masa, janë planifikuar të zbatohen gjatë tremujorit të fundit të vitit.

Nga të gjitha masat e këtij blloku (19), 2 masa legislative (10.5%) ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 0.1.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Kriteret politike – masat e planifikuara për këtë tremujor



Sa i përket zbatimit të masave të këtij blloku të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 2 masat e planifikuara nuk janë zbatuar plotësisht, pra përballen me vonesa serioze.

Bazuar në gjetjet e këtij raporti, masat e këtij blloku të planifikuara për periudhën raportuese të cilat nuk janë zbatuar brenda afatit të paraparë janë si në vijim:

- Miratimi nga Qeveria i projektligjit për plotësim-ndryshim e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me ligjin për procedurën e përgjithshme administrative, faza e dytë;
- Miratimi nga Qeveria i projektligjit për plotësim-ndryshim e Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.


Masat e këtij blloku që pritet të përballen me sfida e vonesa dhe që kërkojnë vëmendje në pjesën e mbetur të vitit janë si në vijim:

- Miratimi nga Qeveria i projektligjit për valën e tretë të racionalizimit të agjencive;
- Miratimi nga Qeveria i projektligjit për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Bashkëpunim Ndër-komunal;
- Rishikimi i planit për racionalizimin e agjencive;
- Hartimi i raportit vjetor për vlerësimin e performancës së agjencive ekzekutive;
- Miratimi i raportit final për performancën e agjencive ekzekutive;
- Vendosja e e-kiosqeve në 20 Komuna të cilat nuk kanë kapacitete financiare.

0.2. Gjendja sipas blloqeve: Kriteret ekonomike

Ky bllok përmban 5 masa zbatuese.

Diagrami 0.2.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut – të gjitha masat




Sa i përket zbatimit të këtij blloku deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 60% e masave, 3 masa, janë zbatuar;
- 20% e masave, 1 masë, përballen me vonesa të vogla;
- 20% e masave, 1 masë, përballen me vonesa serioze.

Nga të gjitha masat e këtij blloku (5), 1 masë (20%) ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 0.2.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Kriteret ekonomike – masat e planifikuara për këtë tremujor



Sa i përket zbatimit të masave të këtij blloku të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 1 masë e planifikuar akoma nuk është zbatuar plotësisht, pra përballen me vonesa serioze.

Bazuar në gjetjet e këtij raporti, masa e këtij blloku e planifikuar për periudhën raportuese e cila nuk është zbatuar brenda afatit të paraparë është si në vijim:

- Raportimi i rregullt gjashtëmujor i zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike 2022-2024.


Masat e këtij blloku që pritet të përballen me sfida e vonesa dhe që kërkojnë vëmendje në pjesën e mbetur të vitit janë si në vijim:

- *Mbajtja e trajnimeve për Departamentin e Makros në MFPT dhe Njësinë për Monitorimin e NP-ve në ME përmes projektit rajonal të asistencë teknike të FMN-FAD të financuar nga BE;*
- *Raportimi i rregullt gjashtëmuor i zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për Menaxhimin e Financave publike 2022-2024.*

0.3. Gjendja sipas blloqeve: Standardet evropiane – përafrimi i legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së

Ky bllok përmban 218 masa: 81 (37.16%) masa legjislative dhe 137 (62.84%) masa zbatuese.

Diagrami 0.3.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Standardet evropiane – të gjitha masat




Sa i përket zbatimit të këtij blloku deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 28.44% e masave, 62 masa, janë zbatuar;
- 40.83% e masave, 89 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 7.34% e masave, 16 masa, përballen me vonesa të vogla;
- 20.67% e masave, 45 masa, përballen me vonesa serioze;
- 2.75% e masave, 6 masa, janë planifikuar të zbatohen gjatë tremujorit të fundit të vitit.

Nga të gjitha masat e këtij blloku (218), 26 (11.92%) prej tyre ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë: 13 masa legjislative dhe 13 masa zbatuese.

Diagrami 0.3.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Standardet evropiane – masat e planifikuara për këtë tremujor



Sa i përket zbatimit të masave të këtij blloku të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 46.15% e masave, 12 masa, janë zbatuar;
- 53.85% e masave, 14 masa, akoma nuk janë zbatuar plotësisht, pra përballen me vonesa serioze.

Bazuar në gjetjet e këtij raporti, masat e këtij blloku të planifikuara për periudhën raportuese të cilat nuk janë zbatuar brenda afatit të paraparë janë si në vijim:

- *Miratimi i rregullores për plotësim-ndryshimin e Rregullores për të Dhënat Statistikore për Shërbimet e Komunikimeve Elektronike;*
- *Miratimi i rregullores për procedurat dhe kriteret në lidhje me marrëveshjet kornizë për alokimin e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore;*
- *Miratimi i rregullores për plotësim-ndryshimin e Rregulloren (AAC) 9/2020 në lidhje me kërkesat për ofruesit e menaxhimit të trafikut ajror/shërbimet e navigimit ajror dhe funksionet e tjera të rrjetit të*

menaxhimit të trafikut ajror në hapësirën ajrore të hapësirës U të përcaktuar në hapësirën ajrore të kontrolluar;

- *Miratimi i koncept dokumenti për transportin e mallrave të rrezikshme;*
- *Miratimi nga Qeveria i projektligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar (plotësim-ndryshim);*
- *Miratimi nga Qeveria i projektligjit për plotësim-ndryshim e ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave;*
- *Miratimi i rregullores për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë;*
- *Miratimi i rregullores për Sistemin e Menaxhimit Informativ të Lëndëve (SMIL);*
- *Miratimi i rregullores së punës së Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit;*
- *Miratimi i rregullores për organizimin e brendshëm të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit;*
- *Miratimi i rregullores për procedurën e hetimeve administrative;*
- *Miratimi i aktit nënligjor për mënyrën e automatizuar të zgjedhjes me short nga lista e subjekteve deklaruese që i nënshtrohen kontrollit të plotë;*
- *Miratimi i strategjisë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre;*
- *Rekrutimi i shtatë (7) zyrtarëve të ndërmjetësimit në prokuroritë themelore;*
- *Miratimi i dokumentit të nevojave të trajnimit për zyrtarët e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit;*
- *Miratimi nga Qeveria i projektligjit për plotësim-ndryshimin e Ligjit për të Huaajt;*
- *Miratimi i strategjisë për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm 2022-2030.*

Masat e këtij blloku që pritet të përballen me sfida e vonesa dhe që kërkojnë vëmendje në pjesën e mbetur të vitit janë si në vijim:

- *Miratimi i rregullores për plotësim-ndryshimin e Rregullores për Autorizimet e Përgjithshme;*
- *Miratimi i rregullores për plotësim-ndryshimin e Rregullores për Kualitetin e Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike;*
- *Miratimi i rregullores për plotësim-ndryshimin e Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturove në Shërbimet Mediale Audio dhe Audiovizuale;*
- *Miratimi i UA-së për zbatimin e UA-së mbi përcaktimin e rregullave shëndetësore për nënproduktet e kafshëve dhe derivatet e tyre, të cilat nuk janë të destinuara për konsum njerëzor;*
- *Miratimi i planit shumëvjeçar të monitorimit dhe kontrollit të sëmundjeve të kafshëve;*
- *Miratimi nga Qeveria i projektligjit për veterinarinë;*
- *Miratimi i Planit për avancimin e ndërmarrjeve agro-ushqimore;*
- *Miratimi i UA për kontrollimin e rregullsisë teknike të automjeteve në rrugë;*
- *Miratimi nga Qeveria i projektligjit për energji;*
- *Miratimi nga Qeveria i projektligjit për rregullatorin e energjisë;*
- *Miratimi nga Qeveria i projektligjit për burimet e ripërtëritshme të energjisë;*
- *Zbatimi i masave të eficiencës së energjisë në sektorin privat dhe atë rezidencial;*
- *Miratimi i aktit nënligjor për zbatimin e buxhetimit gjinor;*
- *Zbatimi i kornizës strategjike për komunitete, kthim dhe integrim;*
- *Sistemimi i së paku dy (2) zyrtarëve në Qendrën e Përkohshme të Pritjes;*
- *Miratimi nga Qeveria i projektligjit për inspektimin në fushën e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor, ndërtimit dhe banimit.*


0.4. Gjendja sipas institucioneve

Kjo pjesë jep një pasqyrë të gjendjes së zbatimit të Programit sipas institucioneve të cilat kanë planifikuar të zbatojnë masa gjatë periudhës korrik – shtator. Me qëllim të vlerësimit të performancës së tyre, institucionet janë ranguar sipas përqindjes së masave të zbatuara, nga institucioni me performancën më të mirë deri te ai me performancën më të dobët.

Të gjitha masat e planifikuara për t'u zbatuar gjatë periudhës korrik – shtator 2023 (29 masa) bien nën përgjegjësinë e 9 institucioneve: 5 institucioneve të Qeverisë dhe 4 institucioneve të tjera.

Nga të gjitha masat e planifikuara për t'u zbatuar gjatë kësaj periudhe (29), 21 (72.41%) prej tyre bien nën përgjegjësinë e institucioneve të Qeverisë, përkatësisht të 5 institucioneve të saj.


Diagrami 0.4.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: performanca e Qeverisë në tërësi



Sa i përket performancës së Qeverisë në tërësi në zbatimin e masave nën përgjegjësinë e saj të planifikuara për t'u zbatuar gjatë periudhës korrik – shtator 2023, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 38.1% e masave, 8 masa, janë zbatuar;
- 61.9% e masave, 13 masa, akoma nuk janë zbatuar plotësisht, pra përballen me vonesa serioze.

Diagrami 0.4.1.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: performanca e secilit institucion të Qeverisë




Sa i përket performancës së secilit institucion të Qeverisë të cilët kanë planifikuar të zbatojnë masa gjatë periudhës korrik – shtator 2023, gjetjet tregojnë si në vijim:

- Ministria e Ekonomisë (ME) – 100% (2 / 2 masa të zbatuara);
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) – 60% (3 / 5 masa të zbatuara);
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) – 50% (1 / 2 masa të zbatuara);
- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) – 22.22% (2 / 9 masa të zbatuara);
- Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) – 0% (0 / 3 masa të zbatuara).

Nga të gjitha masat e planifikuara për t'u zbatuar gjatë kësaj periudhe (29), 8 (27.59%) prej tyre bien nën përgjegjësinë e institucioneve të tjera, përkatësisht të 4 institucioneve të veçanta të kësaj kategorie.

Diagrami 0.4.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: performanca e institucioneve të tjera



Sa i përket performancës së secilit prej institucioneve të tjera të cilët kanë planifikuar të zbatojnë masa gjatë periudhës korrik – shtator 2023, gjetjet tregojnë si në vijim:

- Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) – 100% (1 / 1 masë të zbatuar);
- Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC) – 75% (3 / 4 masa të zbatuara);
- Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) – 0% (0 / 2 masa të zbatuara);
- Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) - 0% (0 / 1 masa të zbatuara).

1. BLOKU 1: KRITERET POLITIKE

1.1. Demokracia dhe sundimi i ligjit

1.1.1. Kushtetuta, parlamenti dhe sistemi zgjedhor

Ky kapitull përmban 1 masë legislative; kjo masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 1.1.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Kushtetuta, parlamenti dhe sistemi zgjedhor – të gjitha masat




Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 1 masë e planifikuar është zbatuar.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, masa e planifikuar në këtë kapitull është zbatuar para periudhës raportuese, përkatësisht gjatë tremujorit të dytë. Ligji për Zgjedhjet është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 8 qershor 2023, duke adresuar rekomandimet e misioneve vëzhguese të BE-së për mbarëvajtjen e zgjedhjeve dhe sfidat e hasura përgjatë proceseve zgjedhore.

1.1.2. Administrata publike

Ky kapitull përmban 16 masa: 6 (37.5%) masa legislative dhe 10 (62.5%) masa zbatuese.

Diagrami 1.1.2.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Administrata publike – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 12.5% e masave, 2 masa, janë zbatuar;
- 37.5% e masave, 6 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 50% e masave, 8 masa, përballen me vonesa serioze. Këto masa janë si në vijim:
 - Miratimi i nga Qeveria i projektligjit për plotësim-ndryshim e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA) – faza e dytë;
 - Miratimi nga Qeveria i projektligjit për plotësim-ndryshim e Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura;
 - Miratimi nga Qeveria i projektligjit për valën e tretë të racionalizimit të agjencive;
 - Miratimi nga Qeveria i projektligjit për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Bashkëpunim Ndërkomunal;
 - Miratimi i planit të rishikuar për racionalizimin e agjencive;
 - Hartimi i raportit vjetor për vlerësimin e performancës së agjencive të ekzekutive;
 - Miratimi i raportit final për performancën e agjencive ekzekutive;
 - Vendosja e e-kiosqeve në 20 komuna të cilat nuk kanë kapacitete financiare.

Nga të gjitha masat e këtij kapitulli (16), 2 masa legislative (12.5%) ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 1.1.2.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Administrata publike – masat e planifikuara për këtë tremujor



Sa i përket zbatimit të masave të këtij kapitulli të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 2 masat e planifikuara nuk janë zbatuar plotësisht, pra përballen me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, masat e planifikuara në këtë fushë përballen me vonesa serioze, në veçanti ato legjislative. Projektligji për plotësim-ndryshim e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me LPPA (faza e dytë) akoma nuk është miratuar nga Qeveria. Sipas raportit të fundit, MFPT është duke përgatitur VNB për këtë projektligj. Nuk ka pasur zhvillime lidhur me projektligjin për plotësim-ndryshim e Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura dhe atij për valën e tretë të racionalizimit të agjencive. Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Bashkëpunim Ndër-komuna është tërhequr nga Programi Legjislativ i Qeverisë për 2023, pasi që nuk ka arritur të miratohet koncepti dokumenti.

Sa u përket masave zbatuese, nuk ka zhvillime rreth hartimit të planit të rishikuar për racionalizimin e agjencive. Hartimi dhe miratimi i raportit vjetor për vlerësimin e performancës së agjencive ekzekutive nuk janë përfunduar; për shkak të ndryshimeve të fundit në legjislacionin lidhur me këtë. mbetet të sqarohet përgjegjësia institucionale për zbatimin e këtyre masave. Për shkak të mungesës së buxhetit gjatë këtij viti nuk do të realizohet vendosja e e-kiosqeve në 20 komuna të cilat nuk kanë kapacitete financiare.

1.1.3. Avokati i Popullit

Ky kapitull përmban 2 masa zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 1.1.3. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Avokati i Popullit – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 2 masat e planifikuara do të zbatohen në tremujorin e fundit të vitit.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, dy masat e planifikuara në kuadër të kësaj fushe e që ndërlidhen me monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit do të raportohen në tremujorin e fundit të vitit.

1.1.4. Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë

Ky kapitull nuk përmban ndonjë masë.

1.2. Bashkëpunimi rajonal dhe obligimet ndërkombëtare


Ky kapitull nuk përmban ndonjë masë.

2. BLOKU 2: KRITERET EKONOMIKE

2.1. Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut

Ky kapitull përmban 5 masa zbatuese.

Diagrami 2.1.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut – të gjitha masat




Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 60% e masave, 3 masa, janë zbatuar;
- 20% e masave, 1 masë, përballen me vonesa të vogla. Kjo masë është si në vijim:
 - Mbajtja e trajnimeve për Departamentin e Makro në MFPT dhe Njësinë për Monitorimin e NP-ve në ME përmes projektit rajonal të asistencë teknike të FMN-FAD të financuar nga BE;
- 20% e masave, 1 masë, përballen me vonesa serioze. Kjo masë është si në vijim:
 - Raportimi i rregullt gjashtëmujor i zbatimit të Planit të Veprimit të SMFP 2022-2024.

Nga të gjitha masat e këtij kapitulli (5), 1 masë (20%) ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 2.1.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut – masat e planifikuara për këtë tremujor



Sa i përket zbatimit të masave të këtij kapitulli të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 1 masë e planifikuar akoma nuk është zbatuar, pra përballen me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, në këtë kapitull nuk ka vonesa serioze, pra masat e planifikuara po zbatohen sipas afateve të parapara me pak vonesa. Gjithsesi, lidhur me masën e pazbatuar, raportimi i rregullt gjashtëmujor i zbatimit të Planit të Veprimit të SMFP 2022-2024, e paraparë të zbatohet në shtator të këtij viti, pritet të zbatohet së shpejti.

2.2. Kapaciteti për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Unionit

Ky kapitull nuk përmban ndonjë masë.

3. BLOKU 3: STANDARDET EVROPIANE – PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME ACQUIS-NË E BE-SË

3.0. Korniza ligjore për përafrimin e legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së

Ky kapitull nuk përmban ndonjë masë.

3.1. Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave

Ky kapitull përmban 12 masa: 3 (25%) masa legislative dhe 9 (75%) masa zbatuese.

Diagrami 3.1.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Lëvizja e lirë e mallrave – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 16.67% e masave, 2 masa, janë zbatuar;
- 25% e masave, 3 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa ;
- 16.67% e masave, 2 masa përballen me vonesa te vogla;
- 41.67% masave, 5 masa përballen me vonesa serioze. Këto masa janë si në vijim:
 - Vendimi për publikimin e listës me titujt dhe referencat e standardeve të harmonizuara për pajisjet elektrike të destinuar për përdorim brenda kufijve të caktuar të tensionit, i miratuar;
 - Vendimi për publikimin e listës me titujt dhe referencat e standardeve të harmonizuara për pajtueshmërinë elektromagnetike, i miratuar;
 - Koncept dokumentit për fushën e Akreditimit, i miratuar;
 - Së paku dhjetë (10) zyrtarë të rinj në inspektoratin e Tregut, të rekrutuar;
 - Së paku pesë (5) zyrtarë të rinj në AMK, të rekrutuar.

Nga të gjitha masat e këtij kapitulli (12), 6 masa (50% e tyre) ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë: 3 masa legislative dhe 3 masa zbatuese.

Diagrami 3.1.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Lëvizja e lirë e mallrave – masat e planifikuara për këtë tremujor



Sa i përket masave të këtij kapitulli të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 33.33% e masave, 2 masa, janë zbatuar;
- 66.67% e masave, 4 masa, akoma nuk janë zbatuar plotësisht, pra përballen me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, ky kapitull karakterizohet me disa vonesa, pasi që një pjesë e masave të planifikuara nuk po realizohen në afatet e parapara. Rekrutimit të 10 zyrtarëve të rinj në Inspektoratin e Tregut gjendet në fazën e verifikimit paraprak të aplikantëve dhe së shpejti pritet të zhvillohet testi me shkrim dhe intervistimi i kandidateve të listës së ngushtë. Sa i përket koncept dokumentit për fushën e akreditimit, është përgatitur dokumenti me propozimet për plotësim-ndryshim të Ligjit për Akreditim, ndërsa rekrutimi i 5 zyrtarëve të rinj në AMK akoma nuk ka filluar.

3.2. Kapitulli 2: Liria e lëvizjes së punonjësve

Ky kapitull nuk përmban ndonjë masë.

3.3. Kapitulli 3: E drejta e themelimit të kompanive dhe liria e ofrimit të shërbimeve

Ky kapitull përmban 4 masa: 2 masa legislative (50%) dhe 2 masa zbatuese (50%).

Diagrami 3.3.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: E drejta e themelimit të kompanive dhe liria e ofrimit të shërbimeve – të gjitha masat




Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 50% e masave, 2 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 50% e masave, 2 masa, përballen me vonesa serioze. Këto masa janë si në vijim:
 - UA për plotësim-ndryshimin e UA për Standardet dhe Procedurat e Verifikimit të Standardeve të Profesionit, i miratuar;
 - Rregullorja për shërbimet e shpërndarjes ndërkufitare të dërgesave, e miratuar.

Nga të gjitha masat e këtij kapitulli (4), 1 masë legislative (25%) ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.3.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: E drejta e themelimit të kompanive dhe liria e ofrimit të shërbimeve – masat e planifikuara për këtë tremujor



Sa i përket zbatimit të masave të këtij kapitulli të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 1 masë e planifikuar akoma nuk është zbatuar plotësisht, pra përballen me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet më lartë, ky kapitull nuk përballen me vonesa të mëdha. Megjithatë, duhet t'i kushtohet rëndësi miratimit të UA për plotësim-ndryshimin e UA për standardet dhe procedurat e verifikimit të standardeve të profesionit si dhe rregullores për shërbimet e shpërndarjes ndërkufitare të dërgesave.

3.4. Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit

Ky kapitull përmban 8 masa: 2 (25%) masa legislative dhe 6 (75%) masa zbatuese.

Diagrami 3.4.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Lëvizja e lirë e kapitalit – të gjitha masat




Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 37.5% e masave, 3 masa, janë zbatuar;
- 37.5% e masave, 3 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 25% e masave, 2 masa, përballen me vonesa serioze. Këto masa, janë si në vijim:
 - Projektligji për shërbimet e pagesave, i miratuar;
 - Koncepti dokumenti për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, i miratuar.

Nga të gjitha masat e këtij kapitulli (8), 1 masë zbatuese (12.5%) ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.4.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Lëvizja e lire e kapitalit – masat e planifikuara për këtë tremujor



Sa i përket zbatimit të masave të këtij kapitulli të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 1 masë e planifikuar është zbatuar.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, ky kapitull nuk karakterizohet me vonesa serioze, pasi që masat e planifikuara po realizohen në afatet e parapara. Rëndësi duhet t'i kushtohet miratimit të koncepti dokumenti për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, pasi miratimit të projektligjit për shërbimet e pagesave.

3.5. Kapitulli 5: Prokurimi publik

Ky kapitull përmban 3 masa: 1 (33.33%) masë legislative dhe 2 (66.67%) masa zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.5. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Prokurimi publik – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 33.33% e masave, 1 masë, janë zbatuar;
- 66.67% e masave, 2 masa, përballen me vonesa serioze. Këto masa janë si në vijim:
 - Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Prokurimin Publik, i miratuar;
 - Dhjetë (10) ekspertë të brendshëm shqyrtues dhe pesë (5) zyrtarë ligjorë, të angazhuar.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, ky kapitull përballen me vonesa serioze pasi që dy masat shumë të rëndësishme – miratimi nga Qeveria i projektligjit për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Prokurimin Publik dhe fuqizimi i kapaciteteve administrative të OSHP-së – akoma nuk janë zbatuar.

3.6. Kapitulli 6: E drejta e kompanive

Ky kapitull përmban 2 masa: 1 (50%) masë legislative dhe 1 (50%) masë zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.6. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: E drejta e kompanive – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:


- 50% e masave, 1 masë, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 50% e masave, 1 masë, përballen me vonesa serioze. Kjo masë është si në vijim:
 - Bordi i mbikëqyrjes publike dhe inspektorëve për kontroll të cilësisë, i funksionalizuar.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, tek ky kapitull ka relativisht vonesa të mëdha. Institucionet duhet t'i kushtojnë vëmendje funksionalizimit të Bordit të mbikëqyrjes publike dhe inspektorëve për kontroll të cilësisë, sepse Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar ka vetëm 3 anëtar aktiv nga 7 anëtarë sa e parasheh ligji. Pra, nuk ka kuorum për të marr vendime.

3.7. Kapitulli 7: E drejta e pronësisë intelektuale

Ky kapitull përmban 5 masa: 1 (20%) masë legislative dhe 4 (80%) masa zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.7. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: E drejta e pronësisë intelektuale – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 40% e masave, 2 masa, janë zbatuar;
- 20% e masave, 1 masë, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 20% e masave, 1 masë, përballen me vonesa serioze. Kjo masë është si në vijim:
 - Programi për pronësi industriale, e miratuar.
- 20% e masave, ose 1 masë, janë planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të fundit të vitit.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, tek ky kapitull nuk ka shumë vonesa serioze. Megjithatë, programi për pronësi industriale i cili është përfshirë si aktivitet në Strategjinë për Zhvillimin e Industrisë nuk është miratuar ende.

3.8. Kapitulli 8: Politikat e konkurrencës

Ky kapitull përmban 4 masa zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.8. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik –shtator 2023: Politikat e konkurrencës – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 75% e masave, 3 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 25% e masave, 1 masë, përballen me vonesa serioze. Kjo masë është si në vijim:
 - Analiza në sektorin financiar, e publikuar.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, shumica e masave e planifikuara po realizohen në afatet e parapara, me përjashtim të analizës në sektorin financiar, e cila ka qenë e planifikuar të realizohet në mars por akoma nuk është përfunduar për shkak të vonesave në vlerësim nga komisioni përkatës.

3.9. Kapitulli 9: Shërbimet financiare

Ky kapitull nuk përmban ndonjë masë.

3.10. Kapitulli 10: Shoqëria e informacionit dhe mediat

Ky kapitull përmban 9 masa: 7 (77.78%) masa legislative dhe 2 (22.22%) masa zbatuese.

Diagrami 3.10.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2023: Shoqëria e informacionit dhe mediat – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 11.11% e masave, 1 masë, janë zbatuar;
- 44.45% e masave, 4 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 44.44% e masave, 4 masa, përballen me vonesa serioze. Këto masa janë si në vijim:
 - Rregullorja për plotësim-ndryshimin e Rregullores për Autorizimet e Përgjithshme, e miratuar;
 - Rregullorja për plotësim-ndryshimin e Rregullores për Kualitetin e Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike, e miratuar;
 - Rregullorja për plotësim-ndryshimin e Rregullores për të Dhënat Statistikore për Shërbimet e Komunikimeve Elektronike, e miratuar;
 - Rregullorja për plotësim-ndryshimin e Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të të Miturove në Shërbimet Mediale Audio dhe Audiovizuale, e miratuar.

Nga të gjitha masat e këtij kapitulli (7), 2 masa legislative (22.22%) ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.10.2. Zbatimi i PKIE-së periudhës korrik – shtator 2023: Shoqëria e informacionit dhe mediat – masat e planifikuara për këtë tremujorë



Sa i përket zbatimit të masave të këtij kapitulli të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:


- 50% e masave, 1 masë është zbatuar;
- 50% e masave, 1 masë, akoma nuk është zbatuar plotësisht, pra përballen me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, në këtë kapitull ka përparim të kufizuar, pasi që deri tani është zbatuar vetëm 1 masë, ndërsa 4 masa legjislative të planifikuara nuk kanë arritur të zbatohen brenda afateve kohore. Sa u përket masave të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, nga masat e planifikuara është zbatuar 1 masë, ndërsa 1 masë përballet me vonesa serioze. Masat e tjera të këtij kapitulli, kryesisht reforma legjislative në fushën e komunikimeve elektronike dhe atë të mediave, janë duke ecur sipas planit dhe pritet të zbatohen brenda afateve. Gjatë tremujorit të fundit të vitit institucionet përgjegjëse duhet të intensifikojnë angazhimin për miratimin e legjislacionit sekondar të planifikuar.

3.11. Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural

Ky kapitull përmban 4 masa: 2 (50%) masë legjislative dhe 2 (50%) masa zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.11. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2023: Bujqësia dhe zhvillimi rural – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 75% e masave, 3 masa, janë zbatuar;
- 25% e masave, 1 masë, janë në zbatim e sipër, pa vonesa.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, tri të katërtat e reformave të planifikuara në këtë kapitull janë zbatuar, ndërsa ngelet vetëm 1 masë për zbatim gjatë tremujorit të fundit. Sidoqoftë, siç është paraqitur më sipër, kjo masë legjislative ka të bëjë me miratimin e projektligjit për tokën bujqësore, e cila është në zbatim e sipër, por që duhet të intensifikohet puna rreth miratimit të tij, pasi që ka ndikim të drejtpërdrejtë në reformimin e këtij kapitulli.

3.12. Kapitulli 12: Politikat e sigurisë së ushqimit, të veterinarisë dhe ato të fitosanitarisë

Ky kapitull përmban 5 masa: 2 (40%) masa legjislative dhe 3 (60%) masa zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.12. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2023: Politikat e sigurisë së ushqimit, të veterinarisë dhe ato të fitosanitarisë – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 20% e masave, 1 masë, janë zbatuar;
- 40% e masave, 2 masa, përballet me vonesa të vogla. Këto masa janë si në vijim:
 - Projektligji për veterinarinë, i miratuar;
 - Plani për avancimin e ndërmarrjeve agro-ushqimore, i miratuar;
- 40% e masave, 2 masa, përballet me vonesa serioze. Këto masa janë si në vijim:
 - UA për zbatimin e UA-së mbi përcaktimin e rregullave shëndetësore për nënproduktet e kafshëve dhe derivatet e tyre, të cilat nuk janë të destinuara për konsum njerëzor, i miratuar;
 - Plani shumëvjeçar i monitorimit dhe kontrollit të sëmundjeve të kafshëve, i miratuar.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, ky kapitull në përgjithësi përballlet me vonesa në realizim, pasi që vetëm 1 masë është zbatuar në tërësi, e cila ka të bëjë me finalizimin e studimit të fizibilitetit mbi funksionimin e fabrikës për trajtimin e nën-produkteve shtazore. Vonesa serioze ka në hartimin e legjislacionit për përcaktimin e rregullave shëndetësore për nën-produktet shtazore dhe të politikave për monitorimin dhe kontrollin e sëmundjeve të kafshëve. Vonesa të vogla ka edhe në hartimin e legjislacionit për veterinarinë dhe të politikave për avancimin e ndërmarrjeve agro-ushqimore. Kësisoj, duhet që gjatë tremujorit të fundit të këtij viti të intensivikohet puna drejt miratimit të tyre, pasi që janë masa që ndikojnë drejtpërdrejt në reformimin e këtij kapitulli.

3.13. Kapitulli 13: Peshkataria

Ky kapitull përmban 1 masë zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.13. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Peshkataria – të gjitha masat




Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 1 masë e planifikuar është në zbatim e sipër, pa vonesa;

Siç tregojnë gjetjet e raportit, masa e planifikuar është në zbatim e sipër. Kjo masë – inventarizimi i peshkut (pilot-projekt) në një pellg lumor – do të zbatohet pasi ekspertët e angazhuar ta prezantojnë raportin me gjetje e rekomandime.

3.14. Kapitulli 14: Politikat e transportit

Ky kapitull përmban 17 masa: 14 (82.35%) masa legjislative dhe 3 (17.65%) masa zbatuese.

Diagrami 3.14.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2023: Politikat e transportit – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 41.18% e masave, 7 masa legjislative, janë zbatuar;
- 29.41% e masave, 5 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 5.88% e masave, 1 masë, përballen me vonesa të vogla. Kjo masë është si në vijim:
 - Rregullorja për kryqëzimet hekurudhë – rrugë, e miratuar;
- 23.53% e masave, 4 masa, përballen me vonesa serioze. Këto masa janë si në vijim:
 - UA për kontrollimin e rregullsisë teknike të automjeteve në rrugë, i miratuar;
 - Rregullorja për procedurat dhe kriteret në lidhje me marrëveshjet kornizë për alokimin e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore, e miratuar;
 - Rregullorja (AAC) që ndryshon Rregulloren (AAC) 9/2020 në lidhje me kërkesat për ofruesit e menaxhimit të trafikut ajror/shërbimet e navigimit ajror dhe funksionet e tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror në hapësirën ajrore të hapësirës U të përcaktuar në hapësirën ajrore të kontrolluar, e miratuar;
 - Koncept dokumenti për transportin e mallrave të rrezikshme, i miratuar.

Nga të gjitha masat e këtij kapitulli (17), 6 (35.3%) prej tyre) ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë: 5 masa legjislative dhe 1 masë zbatuese.

Diagrami 3.14.2. Zbatimi i PKIE-së periudhës korrik – shtator 2023: Politikat e transportit – masat e planifikuara për këtë tremujor



Sa i përket zbatimit të masave të këtij kapitulli të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 50% e masave, 3 masa, janë zbatuar;
- 50% e masave, 3 masa, akoma nuk janë zbatuar plotësisht, pra përballesh me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, deri tani në këtë kapitull ka pasur përparime të kufizuara, pasi që deri janë zbatuar vetëm 7 masa të planifikuara, ndërsa 4 masa (3 masa legjislative dhe 1 masë zbatuese) nuk kanë arritur të zbatohen brenda afateve kohore. Sa i përket zbatimit të masave të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, nga masat e planifikuara janë zbatuar 3 masa, ndërsa 3 masa përballesh me vonesa serioze. Për më tepër, masat e tjera të këtij kapitulli – kryesisht reforma ligjore për transportin rrugor, hekurudhor dhe ajror – janë duke ecur sipas planit dhe pritet të zbatohen brenda afateve të planifikuara. Gjatë tremujorit të fundit të vitit institucionet përgjegjëse duhet të intensifikojnë angazhimet drejt miratimit të legjislacionit primar dhe sekondar në mënyrë që ky kapitull të arrijë të përmbush masat e planifikuara brenda afateve kohore.

3.15. Kapitulli 15: Energjia

Ky kapitull përmban 7 masa: 3 (42.86%) masa legjislative dhe 4 (57.14%) masa zbatuese.

Diagrami 3.15.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2023: Energjia – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 14.29% e masave, 1 masë, janë zbatuar;
- 28.57% e masave, 2 masa, janë në zbatim sipër, pa vonesa;
- 42.86% e masave, 3 masa, përballesh me vonesa të vogla. Këto masa janë si në vijim:
 - Projektligji për energji, i miratuar;
 - Projektligji për rregullatorin e energjisë, i miratuar;
 - Studimi mbi modelet e financimit të masave të eficientës së energjisë në sektorin privat dhe atë rezidencial, i kryer.
- 14.29% e masave, 1 masë, përballesh me vonesa serioze. Kjo masë është si në vijim:
 - Projektligji për burimet e ripërtëritshme të energjisë, i miratuar.

Nga të gjitha masat e këtij kapitulli (7), 1 masë zbatuese (14.28%) ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.15.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Energjia – masat e planifikuara për këtë tremujor




Sa i përket zbatimit të masave të këtij kapitulli të planifikuara për t’u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 1 masë e planifikuar është zbatuar.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, gjatë periudhës raportuese në këtë kapitull ishte planifikuar për t’u zbatuar 1 masë, përkatësisht miratimi i Programit për Zbatimin e Strategjisë së Energjisë, i cili është miratuar. Sa u përket masave të tjera në këtë kapitull, sidomos atyre ligjore, duhet të intensivkohet puna për të zbatuar masat e planifikuara brenda afateve kohore, veçanërisht për projektligjin për burimet e ripërtëritshme të energjisë, i cili përballlet me vonesa serioze.

3.16. Kapitulli 16: Tatimet

Ky kapitull përmban 3 masa zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.16. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Tatimet – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 66.67% e masave, 2 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 33.33% e masave, 1 masë, përballen me vonesa serioze. Kjo masë është si në vijim:
 - Koncepti dokumenti për rishikimin e politikave tatimore, i miratuar.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, në këtë kapitull nuk ka vonesa të mëdha, përveç koncepti dokumentit për rishikimin e politikave tatimore. Grupi punues ka hartuar një draft dhe pritet të shqyrtohet nga MFPT.


3.17. Kapitulli 17: Politikat ekonomike dhe monetare

Ky kapitull nuk përmban ndonjë masë.

3.18. Kapitulli 18: Statistikat

Ky kapitull përmban 8 masa zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.18. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – qershor 2023: Statistikat – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 50.0% e masave, 4 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;

- 50% e masave, 4 masa, janë planifikuar të zbatohen në tremujorin e fundit të vitit.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, ky kapitull nuk përballlet me vonesa serioze, por duhet t'u kushtohet vëmendje disa publikimeve të rëndësishme statistikore, si Bruto Produkti Vendor (BPV) përmes qasjes së të ardhurave.

3.19. Kapitulli 19: Politikat sociale dhe punësimi

Ky kapitull përmban 5 masa zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.19. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Politikat sociale dhe punësimi – të gjitha masat




Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 5 masa të planifikuara janë në zbatim e sipër, pa vonesa.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, ky kapitull nuk përballlet me vonesa, pasi që të gjitha masat janë duke u zbatuar brenda afateve.

3.20. Kapitulli 20: Politikat e ndërmarrjeve dhe ato të industrisë

Ky kapitull përmban 4 masa zbatuese.

Diagrami 3.20.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Ndërmarrjet dhe politikat e industrisë – të gjitha masat




Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 25% e masave, 1 masë, janë zbatuar;
- 25% e masave, 1 masë, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 25% e masave, 1 masë, përballen me vonesa të vogla: Kjo masë është si në vijim:
 - Analiza e ndikimit të zonave ekonomike në zhvillimin e NVM-ve, e kryer;
- 25% e masave, ose 1 masë, përballen me vonesa serioze. Kjo masë është si në vijim:
 - Agjencia për përkrahjen e ndërmarrjeve, e themeluar dhe funksionalizuar.

Nga të gjitha masat e këtij kapitulli (4), 1 masë (25%) ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.20.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Ndërmarrjet dhe politikat e industrisë – masat e planifikuara për këtë tremujor



Sa i përket zbatimit të masave të këtij kapitulli të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 1 masë e planifikuar akoma nuk është zbatuar, pra përballet me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, në këtë kapitull ka progres në zbatim të disa masave dhe vonesa sa i përket themelimit të Agjencisë për Përkrahje të Investimeve, e cila mund të themelohet pas miratimit nga Kuvendi të Ligjit për Investime Strategjike.

3.21. Kapitulli 21: Rrjetet trans-evropiane

Ky kapitull nuk përmban ndonjë masë.


3.22. Kapitulli 22: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore

Ky kapitull nuk përmban ndonjë masë.

3.23. Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Ky kapitull përmban 60 masa: 31 (51.67%) masa legislative dhe 29 (48.33%) masa zbatuese.

Diagrami 3.23.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Gjyqësori dhe të drejtat themelore – të gjitha masat




Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 30% e masave, 18 masa, janë zbatuar;
- 46.67% e masave, 28 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 3.33% e masave, 2 masa, përballen me vonesa të vogla. Këto masa janë si në vijim:
 - Akti nënligjor për zbatimin e buxhetimit gjinor, i miratuar;
 - Pesë (5) takime sipas regjioneve me nivelin komunal për zbatimin e Strategjisë për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre, të organizuara;
- 18.33% e masave, 11 masa, përballen me vonesa serioze. Këto masa janë si në vijim:
 - Projektligji për plotësim-ndryshim e Ligjit për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, i miratuar;
 - Projektligji për plotësim-ndryshim e Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave, i miratuar;
 - Rregullorja për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, e miratuar;
 - Rregullorja për Sistemin e Menaxhimit Informativ të Lëndëve (SMIL);
 - Rregullorja e punës së Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, e miratuar;
 - Rregullorja për organizimin e brendshëm të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, e miratuar;
 - Rregullorja për procedurën e hetimeve administrative, e miratuar;
 - Akti nënligjor për mënyrën e automatizuar të zgjedhjes me short nga lista e subjekteve deklaruese që i nënshtrohen kontrollit të plotë, i miratuar;
 - Strategjia për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, e miratuar;
 - Shtatë (7) zyrtarë të ndërmjetësimit në prokuroritë themelore, të rekrutuar;
 - Dokumenti i nevojave të trajnimit për zyrtarët e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, i miratuar;
- 1.67% e masave, 1 masë, janë planifikuar të zbatohen gjatë tremujorit të fundit të vitit.

Nga të gjitha masat e këtij kapitulli (60), 1 masë legislative (1.67%) ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.23.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Gjyqësori dhe të drejtat themelore – masat e planifikuara për këtë tremujor



Sa i përket zbatimit të masave të këtij kapitulli të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 1 masë e planifikuar është zbatuar.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, ky kapitull përballet me vonesa serioze në zbatim, sidomos të masave të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të parë dhe të dytë. 2 projektligjet dhe 6 aktet nënligjore të planifikuara për t'u miratuar gjatë pjesës së parë të vitit – projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për KPM-në, rregullorja për organizimin e brendshëm të MD-së, Rregullorja për SMIL dhe 4 aktet nënligjore për zbatimin e legjislacionit në fuqi që vendos kompetencat e reja të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (rregullorja e punës së APK-së, rregullorja për organizimin e brendshëm të APK-së, rregullorja për procedurën e hetimeve administrative, dhe akti nënligjor për mënyrën e automatizuar të zgjedhjes me short nga lista e subjekteve deklaruese që i nënshtrohen kontrollit të plotë) – janë duke u hartuar por përballet me vonesa serioze për shkak të kompleksitetit të tyre.

Lidhur me hartimin e politikave dhe avancimin e kornizës institucionale e ngritjen e kapaciteteve në këtë kapitull, akoma nuk janë zbatuar disa masa kyçe. Konkretisht, akoma nuk ka arritur të miratohet strategjia për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre dhe korniza e treguesve për të drejtat e njeriut. Sa i përket avancimit të mëtejshëm të kapaciteteve të sistemin prokurorial, mbetet sfidues rekrutimi i shtatë (7) zyrtarëve të ndërmjetësimit në prokuroritë themelore, pasi që buxheti akoma nuk është miratuar nga Qeveria, përkundër kërkesave të vazhdueshme të KPK-së, dhe këto pozita nuk janë përfshirë në buxhetin e vitit 2023, prandaj kjo masë pritet të mos zbatohet. Në anën tjetër, është miratuar dokumenti i nevojave të trajnimit për zyrtarët e APK-së.

3.24. Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria

Ky kapitull përmban 25 masa: 4 (16%) masa legjislative dhe 21 (84%) masa zbatuese.

Diagrami 3.24.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Drejtësia, liria dhe siguria – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 28% e masave, 7 masa, janë zbatuar;
- 64% e masave, 16 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 4% e masave, 1 masë përballet me vonesa të vogla. Kjo masë është si në vijim:
 - Sistemimi i së paku dy (2) zyrtarëve në Qendrën e Përkohshme të Pritjes;
- 4% e masave, 1 masë përballet me vonesa serioze. Kjo masë është si në vijim:
 - Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për të Huajt, i miratuar.

Nga të gjitha masat e këtij kapitulli (16), 1 masë legjislative (6.25%) ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.24.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Drejtësia, liria dhe siguria – masat e planifikuara për këtë tremujor



Sa i përket zbatimit të masave të këtij kapitulli të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 1 masë e planifikuar akoma nuk është zbatuar, pra përballet me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, masat e planifikuara në këtë kapitull janë duke u zbatuar pa vonesa. Gjatë periudhës raportuese ka pasur zhvillime në avancimin e programit të TI-së me opsionin QlikView për të përfshirë Sistemin e Menaxhimit të Rasteve e Platformën e Inteligjencës Kufitare. Lidhur me avancimin e politikave për riintegrim e integrim të qëndrueshëm, gjatë periudhës raportuese janë miratuar 15 PV lokale dhe të tjerë janë në proces miratimi nga Komunitatet. Më tej, profili i zgjeruar i migrimit 2018-2022, qarkorja informuese për zbatimin e politikave për riintegrim të qëndrueshëm dhe udhëzuesi për monitorimin e integritetit të të huajve, janë duke u hartuar pa vonesa.

Sa i përket fushës së migrimit, gjatë periudhës raportuese janë realizuar 6 trajnime për konventat dhe legjislacionin ndërkombëtar për refugjatë, me pjesëmarrjen e 121 zyrtarëve. Trajnimet janë mbajtur në nivel lokal, ku janë përfshirë të gjitha komunitatet, dhe në atë qendror, ku janë përfshirë të gjitha ministritë relevante për integrimin e të huajve. Më tej, trajnimet në fushën e luftimit të krimit të organizuar dhe bashkëpunimit policor kanë vazhduar sipas planit. Në përgjithësi, të gjitha masat e planifikuara në këtë kapitull janë duke u zbatuar sipas planit ose me pak vonesa, përveç projektligjit për plotësim-ndryshimin e Ligjit për të Huajt, i cili nuk ka arritur të miratohet brenda afatit.

3.25. Kapitulli 25: Shkenca dhe kërkimet shkencore

Ky kapitull përmban 3 masa zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.25. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Shkenca dhe kërkimet shkencore – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:


- 66.67% e masave, 2 masa, janë zbatuar;
- 33.33% e masave, 1 masë, përballet me vonesa të vogla: Kjo masë është si në vijim:
 - Programi Kombëtar i Shkencës, i hartuar.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, ky kapitull nuk përballet me vonesa serioze, pra masat e planifikuara janë duke u zbatuar relativisht brenda afateve.

3.26. Kapitulli 26: Arsimi dhe kultura

Ky kapitull përmban 4 masa zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.26. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – qershor 2023: Arsimi dhe kultura – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 75% e masave, 3 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 25% e masave, 1 masë, përballen me vonesa të vogla: Kjo masë është si në vijim:
 - *Së paku njëzet (20) inspektorë të rinj të arsimit, të rekrutuar.*

Siç tregojnë gjetjet e raportit, ky kapitull nuk përballen me vonesa serioze, pra masat e planifikuara janë në zbatim e sipër.

3.27. Kapitulli 27: Mjedisi

Ky kapitull përmban 13 masa: 4 (30.77%) masa legislative dhe 9 (69.23%) masa zbatuese.

Diagrami 3.27.1. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës janar – shtator 2023: Mjedisi – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 69.23% e masave, 9 masa, janë zbatuar;
- 15.38% e masave, 2 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa;
- 7.69% e masave, 1 masë, përballen me vonesa të vogla. Kjo masë është si në vijim:
 - *Projektligji për inspektimin në fushën e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor, ndërtimit dhe banimit, i miratuar;*
- 7.69% e masave, 1 masë, përballen me vonesa serioze. Kjo masë është si në vijim:
 - *Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Zhvillim të Qëndrueshëm 2022-2030, e miratuar.*

Nga të gjitha masat e këtij kapitulli (13), 4 masa (30.76%) ishin planifikuar të zbatoheshin gjatë tremujorit të tretë: 1 masë legislative dhe 3 masa zbatuese.

Diagrami 3.27.2. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Mjedisi – masat e planifikuara për këtë tremujor



Sa i përket zbatimit të masave të këtij kapitulli të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 75% e masave, 3 masa, janë zbatuar;

- 25% e masave, 1 masë, akoma nuk janë zbatuar plotësisht, pra përballen me vonesa serioze.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, në këtë kapitull 3 nga 4 masat e planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë janë zbatuar: miratimi nga Qeveria i projektligjit për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe i koncept dokumentit për fushën e mbrojtjes së natyrës, dhe identifikimi e reduktimi i deponive ilegale. Në anën tjetër, ka vonesa serioze në miratimin e strategjisë për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm 2022-2030. Në tremujorin e mbetur duhet intensifikuar puna në zbatimin e masave të mbetura, në veçanti të atyre që përballen me vonesa.

3.28. Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit

Ky kapitull përmban 2 masa legislative; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.28. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023:- Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:


- 50% e masave, 1 masë, janë zbatuar;
- 50% e masave, 1 masë, përballen me vonesa të vogla; Kjo masë është si në vijim:
 - UA mbi kërkesat e përcaktuara në relacion me komunikimin tregtar, përfshirë reklamimin apo marketingun, i miratuar.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, ky kapitull nuk ka vonesa në zbatimin e masave, pasi që njëra nga to është zbatuar dhe tjetra është në zbatim e sipër.

3.29. Kapitulli 29: Unioni Doganor

Ky kapitull përmban 3 masa: 1 (33.33%) masë legislative dhe 2 (66.66%) masa zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.29. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Unioni Doganor – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 33.33% e masave, 1 masë, janë zbatuar;
- 66.67% e masave, 2 masa, janë në zbatim e sipër, pa vonesa.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, në këtë kapitull nuk ka vonesa. 1 masë është zbatuar brenda afatit, kurse masat e tjera – realizimi i inspektimeve për luftimin e ekonomisë joformale dhe mashtrimit doganor, ndërmarrja e operacioneve për luftimin e ekonomisë joformale dhe mashtrimit doganor, dhe zhvendosja e së paku 1 terminali doganor në pronë publike e funksionalizimi i tij – janë në zbatim e sipër.

3.30. Kapitulli 30: Marrëdhëniet me jashtë

Ky kapitull përmban 2 masa zbatuese, të gjitha të planifikuara për t'u zbatuar gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.30. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Marrëdhëniet me jashtë – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë se 2 masat e planifikuara akoma nuk janë zbatuar plotësisht, pra përballen me vonesa serioze. Këto masa janë si në vijim:

- Dokumenti për politika tregtare, i miratuar;
- Një (1) zyrtar në Departamentin e Tregtisë, i rekrutuar.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, të gjitha masat e këtij kapitulli përballen me vonesa serioze. Sa i përket dokumentit për politika tregtare, grupi punues është në fazën e hartimit të një drafti, i cili pas finalizimit pritet të dërgohet për miratim. Sa i përket rekrutimit të një (1) zyrtari në Departamentin e Tregtisë, është përzgjedhur dhe do të marrë pozitën pasi të përfundojë periudha e ankesave.

3.31. Kapitulli 31: Politika e jashtme, e sigurisë dhe ajo e mbrojtjes

Ky kapitull nuk përmban ndonjë masë.

3.32. Kapitulli 32: Kontrolli financiar

Ky kapitull përmban 5 masa: 1 (20%) masë legjislative dhe 4 (80%) masa zbatuese; asnjë masë nuk ishte planifikuar të zbatohet gjatë tremujorit të tretë.

Diagrami 3.32. Zbatimi i PKIE-së gjatë periudhës korrik – shtator 2023: Kontrolli financiar – të gjitha masat



Sa i përket zbatimit të këtij kapitulli deri në fund të tremujorit të tretë, gjetjet tregojnë si në vijim:

- 40% e masave, 2 masa, janë zbatuar;
- 60% e masave, 3 masa, përballen me vonesa serioze. Këto masa janë si në vijim:
 - Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës, i miratuar;
 - Strategjia e rishikuar për Komunikim e Zyrës Kombëtare të Auditimit 2023-2026, e miratuar;
 - Rritja e fokusimit të auditimeve të performancës me subjekt interesin publik.

Siç tregojnë gjetjet e raportit, në këtë kapitull ka vonesa. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet miratimit të projektligjit për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës, miratimit të strategjisë së komunikimit të ZKA-së dhe fokusimit më të madh në auditimet e performancës me subjekt interesin publik.

3.33. Kapitulli 33: Dispozitat financiare dhe ato buxhetore

Ky kapitull nuk përmban ndonjë masë.

Shtojcë: Pasqyrë e zbatimit të PKIE gjatë vitit 2023 - gjendja e zbatimit deri në fund të tremujorit të tretë

MASAT LEGJISLATIVE

Nr.	Dispozitat e MSA-së	Aktet kombëtarë që do të harmonizohen	Aktet e acquis-së së BE-së që do të transpozohen	Inst. përgjegjëse	Afatet	Gjendja e zbatimit
1. BLOKU I: KRITERET POLITIKE						
1.1. Demokracia dhe sundimi i ligjit						
1.1.1. Kushtetuta, parlamenti dhe sistemi zgjedhor						
1.1.1.	Legjislacioni kornizë					
1.1.1.1.	Neni 120	Legjislacioni i ri për zgjedhje, i miratuar		Kuvendi	K4 2023	E zbatuar
1.1.2. Administrata publike						
1.1.2.	Legjislacioni kornizë					
1.1.2.1.	Neni 120	Projektligji për plotësim-ndryshim e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me ligjin për procedurën e përgjithshme administrative, faza e dytë, i miratuar		MPB	K3 2023	Vonesa serioze
1.1.2.2.	Neni 120	Projektligji për plotësim-ndryshim e Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, i miratuar		MPB	K3 2023	Vonesa serioze
1.1.2.3.	Neni 120	Projektligji për valën e tretë të racionalizimit të agjencive, i miratuar		MPB	K4 2023	Vonesa serioze
1.1.2.4.	Neni 120	Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i miratuar		MAPL	K4 2023	Në zbatim e sipër, pa vonesa
1.1.2.5.	Neni 120	Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Bashkëpunim Ndër-komunal, i miratuar		MAPL	K4 2023	Vonesa serioze
1.1.2.	Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative					
1.1.2.6.	Neni 120	UA për administratën e hapur lokale, i miratuar		MAPL	K4 2023	Në zbatim e sipër, pa vonesa
3. BLOKU III: STANDARDET EVROPIANE – PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME ACQUIS-NË E BE-SË						
3.1. Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave						
3.1.	Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative					
3.1.1.	Nenet 20, 80, 74 – pika 3	Rregullorja për plotësim-ndryshimin e Rregullores (MINT) nr. 01/2018 për Etiketimin dhe Shënjimin e Produkteve të Tekstilit, e miratuar	Rregullorja e deleguar e Komisionit (BE) 2018/122 e datës 20 tetor 2017 që ndryshon anekset I, II, VI, VIII dhe IX të Rregullores nr. 1007/2011 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi emrat e fibrave tekstile dhe etiketimin dhe shënimin përkatës të përbërjes së fibrave të produkteve tekstile	MINT	K3 2023	E zbatuar
3.1.2.	Nenet 20, 80, 74 – pika 3	Vendimi për publikimin e listës me titujt dhe referencat e standardeve të harmonizuara për pajisjet elektrike të destinuar për përdorim brenda kufijve të caktuar të tensionit, i miratuar	Përmbledhje e referencave të standardeve të harmonizuara të publikuara në Gazetën Zyrtare Direktiva 2014/35/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 shkurt 2014 mbi harmonizimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me vënien në dispozicion në treg të pajisjeve elektrike të projektuara për përdorim brenda kufijve të caktuar të tensionit (10.05.2022)	MINT	K3 2023	Vonesa serioze
3.1.3.	Nenet 20, 80, 74 – pika 3	Vendimi për publikimin e listës me titujt dhe referencat e standardeve të harmonizuara për pajtueshmërinë elektromagnetike, i miratuar	Përmbledhje e referencave të standardeve të harmonizuara të publikuara në Gazetën Zyrtare	MINT	K3 2023	Vonesa serioze

			Direktiva 2014/30/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 shkurt 2014 për harmonizimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me përputhshmërinë elektromagnetike (19.09.2022)			
3.3. Kapitulli 3: E drejta e themelimit dhe liria e ofrimit të shërbimeve						
3.3.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>					
3.3.1.	Nenet 51, 56, 57, 58, 59, 74	UA për plotësim-ndryshimin e UA për Standardet dhe Procedurat e Verifikimit të Standardeve të Profesionit, i miratuar	Direktiva 2005/36/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian e datës 7 shtator 2005 mbi njohjen e kualifikimeve profesionale Direktiva 2013/55/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian e datës 20 nëntor 2013 (që ndryshon direktivën 2005/36 / EC mbi njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Rregulloren (BE) Nr. 1024/2012 për bashkëpunim administrativ përmes Sistemit Informativ të Tregut të Brendshëm (Rregullorja IMI) për njohjen e kualifikimeve profesionale)	MASHTI	K4 2023	Vonesa serioze
3.3.2.	Nenet 51, 56, 57, 58, 59, 74	Rregullorja për shërbimet e shpërndarjes ndërkufitare të dërgesave, e miratuar	Rregullorja (BE) 2018/644	ARKEP	K3 2023	Vonesa serioze
3.4. Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit						
3.4.	<u>Legjislati kornizë</u>					
3.4.1.	Neni 89	Projektligji për regjistrin e pronarëve përfitues, i miratuar	Direktiva 2015/849/BE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 20 maj 2015, për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose të financimit të terrorizmit, që ndryshon Rregulloren (BE) nr. 648/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, dhe që shfuqizon Direktivën 2005/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Direktivën e Komisionit 2006/70/KE	MINT	K4 2023	Në zbatim e sipër, pa vonesa
3.4.2.	Neni 64	Projektligji për shërbimet e pagesave, i miratuar	Direktiva PSD 2	MFPT	K4 2023	Vonesa serioze
3.5. Kapitulli 5: Prokurimi publik						
3.5.	<u>Legjislati kornizë</u>					
3.5.1.	Neni 79	Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Prokurimin Publik, i miratuar	Direktiva 2014/24/BE për prokurimin në sektorin klasik Direktiva 2014/25/BE për shërbime/utilitete Direktiva 2009/81/KE Direktiva e Këshillit 89/665/KEE Direktiva e Këshillit 92/13/KEE	MFPT	K1 2023	Vonesa serioze
3.6. Kapitulli 6: E drejta e kompanive						
3.6.	<u>Legjislati kornizë</u>					
3.6.1.	Neni 51	Projektligji për shoqëritë tregtare, i miratuar	Direktiva (BE) 2017/1132 Direktiva (BE) 2017/828 Direktiva 2019/1151 Direktiva 2019/2121 Direktiva 2004/109/KE Direktiva 2013/50/BE	MINT	K4 2023	Në zbatim e sipër, pa vonesa
3.7. Kapitulli 7: E drejta e pronësisë intelektuale						
3.7.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>					
3.7.1.	Nenet 77-78	UA për procedurat, kushtet për licencimin e organizatave të menaxhimit kolektiv, i miratuar		MKRS	K4 2023	Në zbatim e sipër, pa vonesa
3.10. Kapitulli 10: Shoqëria e informacionit dhe mediat						
3.10.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>					
3.10.1.	Nenet 109-111	Rregullorja për plotësim-ndryshimin e Rregullores për Autorizimet e Përgjithshme, e miratuar	Direktiva (BE) 2018/1972 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 11 dhjetor 2018 për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike	ARKEP	K2 2023	Vonesa serioze

3.10.2.	Nenet 109-111	Rregullorja për plotësim-ndryshimin e Rregullores për Kualitetin e Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike, e miratuar	Direktiva (BE) 2018/1972 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 11 dhjetor 2018 për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike	ARKEP	K2 2023	Vonesa serioze
3.10.3.	Nenet 109-111	Rregullorja për plotësim-ndryshimin e Rregullores për të Dhënat Statistike për Shërbimet e Komunikimeve Elektronike, e miratuar	Direktiva (BE) 2018/1972 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 11 dhjetor 2018 për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike	ARKEP	K3 2023	Vonesa serioze
3.10.4.	Nenet 109-111	Rregullorja për plotësim-ndryshimin e Rregullores për Kontratat, Transparencën dhe Publikimin e Informatave dhe Masave të Tjera Mbrojtëse për Përdoruesit Fundorë për Ofrimin e Rrjeteve dhe Shërbimeve Publike të Komunikimeve Elektronike, e miratuar	Direktiva (BE) 2018/1972 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 11 dhjetor 2018 për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike	ARKEP	K4 2023	Në zbatim e sipër, pa vonesa
3.10.5.	Nenet 109-111	Rregullorja për pronësinë dhe koncentrimin e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale, e miratuar	Direktiva për Shërbimet Mediale Audiovizuale - AVMSD	KPM	K4 2023	Në zbatim e sipër, pa vonesa
3.10.6.	Nenet 109-111	Rregullorja për plotësim-ndryshimin e Rregullores për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, e miratuar	Direktiva për Shërbimet Mediale Audiovizuale - AVMSD	KPM	K4 2023	Në zbatim e sipër, pa vonesa
3.10.7.	Nenet 109-111	Rregullorja për plotësim-ndryshimin e Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të të Miturve në Shërbimet Mediale Audio dhe Audiovizuale, e miratuar	Direktiva për Shërbimet Mediale Audiovizuale - AVMSD	KPM	K2 2023	Vonesa serioze
3.11. Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural						
3.11.	<u>Legjisllacioni kornizë</u>					
3.11.1.	Neni 102	Projektligji për organizimin e tregut të përbashkët të produkteve bujqësore, i miratuar	Rregullorja e (BE) nr. 1308/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për organizimin e tregut të përbashkët, e ndryshuar me Rregulloren (BE) 2021/20117 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 2 dhjetor 2021 Rregullorja e deleguar e Komisionit (BE) 2017/891 e datës 13 mars 2017 që plotëson Rregulloret (BE) Nr 1308/2013, 1306/2013, 543/2011, e ndryshuar me Rregulloren e deleguar e Komisionit (BE) 2021/2245 e datës 12 tetor Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2017/892 e datës 13 mars 2017 që përcakton rregullat për zbatimin e Rregullores (BE) nr. 1308/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me sektorët e pemëve dhe perimeve me Rregulloren Zbatuese e Komisionit (BE) 2018/1146 e datës 7 qershor 2018 Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) nr. 543/2011 e qershorit 2011 që përcakton rregullat e detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 1234/2007 në lidhje me sektorët e pemëve dhe perimeve dhe pemëve dhe perimeve të përpunuara me Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2021/1926 e datës 5 nëntor 2021 Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2017/39 e datës 3 nëntor 2016 mbi rregullat për zbatimin e Rregullores (BE) nr. 1308/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me ndihmën e Bashkimit për furnizimin me pemë dhe perime, banane dhe qumësht në institucionet arsimore e ndryshuar me Rregulloren Zbatuese e Komisionit (BE) 2022/246 e datës 13 dhjetor 2021 Rregullorja e deleguar e Komisionit (BE) 2017/40 e datës 3 nëntor 2016 që plotëson Rregulloren (BE) nr. 1308/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me ndihmën e Bashkimit për furnizimin me pemë dhe perime, banane dhe qumësht në institucionet arsimore dhe ndryshimin e Rregullores (BE) nr. 907/2014 e ndryshuar me Rregulloren	MBPZhR	K1 2023	E zbatuar

			e deleguar e Komisionit (BE) 2022/245 e datës 13 dhjetor 2021 Rregullorja (BE) 2021/2117 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 2 dhjetor 2021 e ndryshuar me Rregulloret (BE) nr. 1308/2013, (BE) nr. 1151/2012, (BE) nr. 251/2014 dhe (BE) nr. 228/2013 Rregullorja (BE) nr. 1151/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21 nëntor 2012 mbi skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe ushqimet e ndryshuar me Rregulloren (BE) 2021/2117 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 2 dhjetorit 2021			
3.11.2.	Neni 102	Projektligji për tokën bujqësore, i miratuar	Karta Evropiane për Planifikim Hapësinor, e miratuar në Konferencën e 6-të e Ministrave Evropianë përgjegjës për Planifikimin Rajonal të mbajtur në Torremolinos në maj të vitit 1983 dhe miratuar nga Këshilli i Evropës dhe Perspektiva Evropiane për Planifikim Hapësinor (1999)	MBPZHR	K4 2023	<i>Në zbatim e sipër, pa vonesa</i>
3.12. Kapitulli 12: Politikat e sigurisë së ushqimit, fitosanitare dhe ato të veterinarisë						
3.12.	<u>Legjislacioni kornizë</u>					
3.12.1.	Neni 102	Projektligji për veterinarinë, i miratuar	Rregullorja (BE) nr. 2016/429 për sëmundjet e transmetueshme të kafshëve	MBPZHR	K4 2023	<i>Vonesa të vogla</i>
3.12.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>					
3.12.2.	Neni 102	UA për zbatimin e UA-së mbi përcaktimin e rregullave shëndetësore për nënproduktet e kafshëve dhe derivatet e tyre, të cilat nuk janë të destinuar për konsum njerëzor, i miratuar	Rregullorja e Komisionit nr. 142/2011 që zbaton Rregulloren nr. 1069/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e cila parashton rregullat e shëndetit në lidhje me nënproduktet shtazore dhe produkteve që rrjedhin nga to jo të destinuar për konsum njerëzor dhe zbatimin e Direktivës së Këshilli 97/78/KE në lidhje me mostra të caktuara dhe artikuj të cilët përjashtohen nga kontrollet veterinarë në kufi nën këtë direktivë	AUV	K1 2023	<i>Vonesa serioze</i>
3.14. Kapitulli 14: Politikat e transportit						
3.14.	<u>Legjislacioni kornizë</u>					
3.14.1.	Neni 113	Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Transportin Rrugor, i miratuar	Direktiva nr.1071/2009/KE për qasje në profesion të operatoreve të transportit rrugor Direktiva nr. 1072/2009/KE për rregullat e përbashkëta në qasje në transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave Direktiva nr. 1073/2009/KE për rregullat e përbashkëta për qasje në tregun ndërkombëtar për ekuipazhin e automjetit dhe shërbimet e transportit të udhëtarëve Rregullorja 2016/68 mbi procedurat dhe specifikimet e përbashkëta të nevojshme për ndërlidhjen e regjistrave elektronikë të kartave të shoferëve Rregullorja 165/2014 e BE e cila rregullon kohën e ngasjes dhe pushimit	MMPHI	K4 2023	<i>Në zbatim e sipër, pa vonesa</i>
3.14.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>					
3.14.2.	Neni 113	UA për kontrollimin e rregullsisë teknike të automjeteve në rrugë, i miratuar	Direktiva 2014/47 për kontrollimin teknik mobil	MMPHI	K2 2023	<i>Vonesa serioze</i>
3.14.3.	Neni 113	Rregullorja për specifikacione teknike për interoperabilitet në lidhje me nën-sistemin "aplikacionet telematike për mallra" - STITAF, e miratuar	Rregullore (BE) 1305/2014 e datës 11 dhjetor 2014, për specifikacione teknike për interoperabilitet në lidhje me nën-sistemin aplikacionet telematike për mallra - STI TAF	ARH	K4 2023	<i>Në zbatim e sipër, pa vonesa</i>
3.14.4.	Neni 113	Rregullorja për plotësim-ndryshimin e Rregullores nr. 05/2012 për Regjistrimin Nacional të Mjeteve Lëvizëse, e miratuar	Rregullore e Vendimit Zbatues të Komisionit (BE) 2018/1614 i datës 25 tetor 2018, për Regjistrimin Nacional të Mjeteve Lëvizëse	ARH	K4 2023	<i>Në zbatim e sipër, pa vonesa</i>

3.14.5.	Neni 113	Rregullorja për procedurat dhe kriteret në lidhje me marrëveshjet kornizë për alokimin e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore, e miratuar	Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2016/545 e datës 7 prill 2016 mbi procedurat dhe kriteret në lidhje me marrëveshjet kuadër për alokimin e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore (OJ BE L 94, 8.4.2016, fq. 1)	ARH	K3 2023	Vonesa serioze
3.14.6.	Neni 113	Rregullorja për Kryqëzimet Hekurudhë- Rrugë, e miratuar	Rregulloja për kalimet në nivel - Treguesit e sigurisë së përbashkët të Bashkimit Evropian (referuar Direktivës së Komisionit 2014/88/BE e datës 9 korrik 2014 që ndryshon Direktivën 2004/49/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me treguesit e përbashkët të sigurisë dhe metodat e zakonshme të llogaritjes së kostove të aksidenteve	ARH	K4 2023	Vonesa të vogla
3.14.7.	Neni 113	Rregullorja (AAC) që ndryshon Rregulloren (AAC) nr. 17/2017 për sa i përket kërkesave për operimet në çdo mot, e miratuar	Rregullorja e Deleuar e Komisionit (BE) 2022/208 e datës 14 dhjetor 2021 që ndryshon Rregulloren (BE) nr. 139/2014 për sa i përket kërkesave për operimet në çfarëdo mot	AAC	K1 2023	E zbatuar
3.14.8.	Neni 113	Rregullorja (AAC) që ndryshon Rregulloren (AAC) nr. 6/2015 në lidhje me zbatimin e kërkesave më proporcionale për avionët e përdorur për aviacion sportiv dhe rekreativ, e miratuar	Rregullorja e deleuar e Komisionit (BE) 2022/1358 e datës 2 qershor 2022 që ndryshon Rregulloren (BE) nr. 748/2012 në lidhje me zbatimin e kërkesave më proporcionale për avionët e përdorur për aviacion sportiv dhe rekreativ	AAC	K1 2023	E zbatuar
3.14.9.	Neni 113	Rregullorja (AAC) për korrigjimin e Rregullores (AAC) nr. 6/2015 në lidhje me shmangiet nga disa kërkesa të paraqitura nga Rregullorja e AAC që do të transponojë Rregulloren e Deleuar (BE) 2022/201, e miratuar	Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2022/1253 e datës 19 korrik 2022 për korrigjimin e Rregullores (BE) nr. 748/2012 në lidhje me shmangiet nga disa kërkesa të paraqitura nga Rregullorja e Deleuar (BE) 2022/201	AAC	K2 2023	E zbatuar
3.14.10.	Neni 113	Rregullorja (AAC) që ndryshon Rregulloren (AAC) 1/2019 në lidhje me futjen e kërkesave të reja shtesë të vlefshmërisë ajrore, e miratuar	Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2022/1254 e datës 19 korrik 2022 që ndryshon Rregulloren (BE) 2015/640 në lidhje me futjen e kërkesave të reja shtesë të vlefshmërisë ajrore	AAC	K2 2023	E zbatuar
3.14.11.	Neni 113	Rregullorja (AAC) që ndryshon Rregulloren (AAC) nr. 7/2015 në lidhje me zbatimin e kërkesave më proporcionale për avionët e përdorur për aviacion sportiv dhe rekreativ, e miratuar	Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2022/1360 e datës 28 korrik 2022 që ndryshon Rregulloren (BE) nr. 1321/2014 në lidhje me zbatimin e kërkesave më proporcionale për avionët e përdorur për aviacion sportiv dhe rekreativ	AAC	K3 2023	E zbatuar
3.14.12.	Neni 113	Rregullorja (AAC) që ndryshon Rregulloren (AAC) 9/2020 në lidhje me kërkesat për ofruesit e menaxhimit të trafikut ajror/shërbimet e navigimit ajror dhe funksionet e tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror në hapësirën ajrore të hapësirës U të përcaktuar në hapësirën ajrore të kontrolluar, e miratuar	Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2021/665 e datës 22 prill 2021 që ndryshon Rregulloren Zbatuese (BE) 2017/373 në lidhje me kërkesat për ofruesit e menaxhimit të trafikut ajror/shërbimet e navigimit ajror dhe funksionet e tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror në hapësirën ajrore të hapësirës U të përcaktuar në hapësirën ajrore të kontrolluar	AAC	K3 2023	Vonesa serioze
3.14.13.	Neni 113	Rregullorja (AAC) që përcakton masat për zbatimin e Rregullores (AAC) nr. 9/2017 në lidhje me skemën e përbashkët evropiane të klasifikimit të rrezikut, e miratuar	Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2021/2082 e datës 26 nëntor 2021 që përcakton masat për zbatimin e Rregullores (BE) nr. 376/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me skemën e përbashkët evropiane të klasifikimit të rrezikut	AAC	K3 2023	E zbatuar
3.14.14.	Neni 113	Rregullorja (AAC) që ndryshon Rregulloren (AAC) 6/2015 në lidhje me certifikimin, mbikëqyrjen dhe detyrat e zbatimit të autoriteteve kompetente në zbatimin e rregullave në lidhje me organizatat e përfshira në projektimin dhe prodhimin të avionëve të përdorur për aviacion sportiv dhe rekreativ, e miratuar	Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2022/1361 e datës 28 korrik 2022 që ndryshon Rregulloren (BE) nr. 748/2012 në lidhje me certifikimin, mbikëqyrjen dhe detyrat e zbatimit të autoriteteve kompetente në zbatimin e rregullave në lidhje me organizatat e përfshira në projektimin dhe prodhimin të avionëve të përdorur për aviacion sportiv dhe rekreativ	AAC	K3 2023	E zbatuar
3.15. Kapitulli 15: Energjia						
3.15.	Legjislacioni kornizë					
3.15.1.	Neni 114	Projektligji për energji, i miratuar	Direktiva mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike (BE) 2019/944 Rregullorja për tregun e brendshëm të energjisë elektrike (BE) 2019/943	ME	K4 2023	Vonesa të vogla

			Rregullorja për Gatishmërinë ndaj rrezikut në sektorin e energjisë elektrike BE 2019/941 Rregullore mbi Qeverisjen e Unionit të Energjisë dhe Veprimet klimatik (BE) 2018/1999 Rregullorja mbi Agjencinë e Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (BE) 2019/942			
3.15.2.	Neni 114	Projektligji për rregullatorin e energjisë, i miratuar	Direktiva mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike (BE) 2019/944 Rregullorja për tregun e brendshëm të energjisë elektrike (BE) 2019/943 Rregullorja për Gatishmërinë ndaj rrezikut në sektorin e energjisë elektrike BE 2019/941 Rregullore mbi Qeverisjen e Unionit të Energjisë dhe Veprimet klimatik (BE) 2018/1999 Rregullorja mbi Agjencinë e Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (BE) 2019/942	ME	K4 2023	Vonesa të vogla
3.15.3.	Neni 114	Projektligji për burimet e ripërtëritshme të energjisë, i miratuar	Direktiva për Promovimin e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë 2018/2001/BE	ME	K2 2023	Vonesa serioze
3.23. Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore						
3.23.	<u>Legjislacioni kornizë</u>					
3.23.	Politikat kundër korrupsionit					
3.23.1.	Neni 91	Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, i miratuar		MD	K4 2023	Vonesa serioze
3.23.	Të drejtat themelore					
3.23.2.	Nenet 3-4	Projektligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna në baza gjinore, i miratuar	Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit)	Kuvendi	K2 2023	E zbatuar
3.23.3.	Nenet 3-4	Projektligji për plotësim-ndryshim e Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave, i miratuar		ZKM	K2 2023	Vonesa serioze
3.23.4.	Nenet 3-4	Projektligji për plotësim-ndryshim e Ligjit për Lirinë Fetare në Kosovë, i miratuar		ZKM	K1 2023	E zbatuar
3.23.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>					
3.23.	Sistemi gjyqësor					
3.23.5.	Neni 83 dhe 91	Rregullore për organizimin e brendshëm të MD, e miratuar		MD	K2 2023	Vonesa serioze
3.23.6.	Neni 83 dhe 91	Rregullore për disiplinimin e anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës, e miratuar		KPK	K4 2023	Në zbatim e sipër, pa vonesa
3.23.7.	Neni 83 dhe 91	Rregullore për arkivimin e dokumenteve për Prokurorin e Shtetit, e miratuar		KPK	K4 2023	Në zbatim e sipër, pa vonesa
3.23.8.	Neni 83 dhe 91	Rregullorja për plotësim- ndryshimin e Rregullores nr. 05/2019 për Procedurën Disiplinore ndaj Prokurorëve, e miratuar		KPK	K4 2023	Në zbatim e sipër, pa vonesa
3.23.9.	Neni 83 dhe 91	Rregullorja për vlerësimin e performancës së prokurorëve të shtetit, e miratuar		KPK	K4 2023	Në zbatim e sipër, pa vonesa
3.23.10.	Neni 83 dhe 91	Rregullorja për SMIL, e miratuar		KGjK	K2 2023	Vonesa serioze
3.23.11.	Neni 83 dhe 91	Rregullorja për trajnime, e miratuar		KGjK	K4 2023	Në zbatim e sipër, pa vonesa
3.23.12.	Neni 83 dhe 91	Rregullorja për dosjen e administratës, e miratuar		KGjK	K4 2023	Në zbatim e sipër, pa vonesa
3.23.	Politikat kundër korrupsionit					

3.23.13.	Neni 91	Rregullore e punës e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, e miratuar		APK	K1 2023	Vonesa serioze
3.23.14.	Neni 91	Rregullore për organizimin e brendshëm të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, e miratuar		APK	K1 2023	Vonesa serioze
3.23.15.	Neni 91	Rregullore për procedurën e hetimeve administrative, e miratuar		APK	K2 2023	Vonesa serioze
3.23.16.	Neni 91	Akt nënligjor për përcaktimin e metodologjisë uniforme dhe udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e Planeve të Integritetit, e miratuar		APK	K2 2023	E zbatuar
3.23.17.	Neni 91	Akt nënligjor për përcaktimin e Metodologjisë për vlerësimin e rrezikut, e miratuar		APK	K2 2023	E zbatuar
3.23.18.	Neni 91	Akt nënligjor për përcaktimin e Metodologjisë për vlerësimin e potencialit të korrupsionit në legjislacion, e miratuar		APK	K2 2023	E zbatuar
3.23.19.	Neni 91	Akt nënligjor për përcaktimin dhe përditësimin rregullisht të listës së pozitive të cilave u kërkohet deklarimi i pasurisë, e miratuar		APK	K2 2023	E zbatuar
3.23.20.	Neni 91	Akt nënligjor për përcaktimin e mënyrës elektronike të deklarimit në lidhje me statusin dhe prejardhjen e pasurive, e miratuar		APK	K2 2023	E zbatuar
3.23.21.	Neni 91	Akt nënligjor për mënyrën e automatizuar të zgjedhjes me short nga lista e subjekteve deklaruese që i nënshtrohen kontrollit të plotë, e miratuar		APK	K2 2023	Vonesa serioze
3.23.	Të drejtat themelore					
3.23.22.	Nenet 3-4	UA (masë afirmative) për regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve, i miratuar		ZKM	K2 2023	E zbatuar
